

VENDIM
Nr.661, datë 25.9.2003

**PËR KALIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSITAR TË ORTOPEDI-TRAUMATOLOGJISË, NË
VARËSI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 129 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të neneve 10 e 16 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi universitar i ortopedi-traumatologjisë kalon në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Ministrisë së Shëndetësisë në numrin e punonjësve, miratuar për vitin 2003, t’i shtohen 89 (tetëdhjet e nëntë) punonjës, numër i cili i zbritet Ministrisë së Mbrojtjes nga numri i punonjësve, i miratuar për vitin 2003.

3. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet fondi prej 7 970 000 (shtatë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për punonjësit e shërbimit universitar të ortopedi-traumatologjisë, fond, i cili i zbritet buxhetit të vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Shpenzimet për mallra e shërbime të shërbimit universitar të ortopedo-traumatologjisë, deri në fund të këtij viti, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Shërbimi universitar i ortopedi-traumatologjisë, deri në sigurimin e mjediseve të përshtatshme, brenda vitit 2005, ta ushtrojë veprimtarinë e vet në mjediset dhe me pajisjet e Spitalit Ushtarak Qendror Universitar, sipas një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Për vitin 2004 e në vazhdim Ministria e Shëndetësisë të parashikojë në buxhet shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative, vetëm për medikamente dhe materiale mjekësore, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve operative të vazhdojë të përballohet nga Ministria e Mbrojtjes, sipa pikës 5 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.9.2003.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano